REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2022:120042
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05424387

P.nr.83/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega Leposaviq, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Mersiha Čalaković Pllana, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurve: D.E., për shkak të veprës penale: Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit (Nr. 06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si:KPRK*) dhe E.E.për veprën penale: Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1126/22 të datës 13.06.2022, duke vendosur sipas kërkesës për shqiptimin e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1126/22 e datës 13.06.2022, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPPK), u jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurëve:

1.D.E., nga i ati .., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ..., në ..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit .....5, boshnjak, banor i Republikës së Kosovës.

2022:120043

2. E.E., nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., e lindur me datë ..., në ..., me vendbanim në fshatin ..., ka të kryer shkollën e mesme, e martuar, e pa punë, e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., boshnjake, banore e Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

SEPSE:

1. I pandehuri i parë me datë 20.05.2022, rreth orës 17:00, përmes rrugëve alternative nga Republika e Serbisë nëpërmjet fshatit Sharpel – Leposaviq, në territorin e Republikës të Kosovës, ku nuk është vend kalimi kufitar legal i Republikës së Kosovës, kanë kaluar kufirin dhe atë me automjet të tipit "Audi A3", ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit ..., me të cilën e ka drejtuar së bashku me bashkëshorten e saj të pandehurën e dytë, për të anashkaluar pikën kufitare legale, me ç'rast është ndaluar nga ana e policisë kufitare, vija e gjelbërt e patrollës policore PSNG Leposaviq, ku automjeti është vërejtur në pikën e kontrollit në lokacionin tek fshati Bistricë, ku i njëjti hynë nga territori i Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, në kontrollin e hyrjes dhe daljes të personave në pikën kufitare legale në Jarinjë është vërtetuar se personi me datë 20.05.2022 rreth orës 09:25 minuta në mënyrë legale është dalë nga territori i Republikës të Kosovës.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

2.E pandehura e dytë me datë 20.05.2022, rreth orës 17:00, përmes rrugëve alternative nga Republika e Serbisë përmes fshatit Sharpel – Leposaviq, në territorin e Kosovës, i cili nuk është vendkalim kufitar legal i Republikës të Kosovës, ka kaluar kufirin dhe atë me automjetin e tipit "Audi A3", ngjyrë hiri, me tabela të regjistrimit ..., të cilën e ka drejtuar i pandehuri i parë, për të anashkaluar pikën kufitare legale dhe me ç'rast është ndaluar nga ana e policisë kufitare, vija e gjelbërt e patrollës policore PSNG Leposaviq, të cilin automjeti e kanë vërejtur në pikën e kontrollit në fshatin Bistricë, se i njëjti hyn nga territori i Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, në kontrollin e hyrjes dhe daljes të personave në pikën kufitare legale në Jarinjë është vërtetuar se personi me datë 20.05.2022 rreth orës 09:25 minuta në mënyrë legale është dalë nga territori i Republikës të Kosovës.

- Me këtë ka kryer veprën penale: Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

2022:120043

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4 ,7 ,8, 17, 21, 38, 39, 40, 43, dhe nenit 140 të KPRK-së, si dhe bazuar në nenet 364, 449, 493 dhe 495 të KPPK-së, ju:

S H Q I P T O N

I. TË PANDEHURIT: D.E., DËNIM ME GJOBË në shumën prej 250 (dyqind e pesdhjete) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. TË PANDEHURËS: E.E., DËNIM ME GJOBË në shumën prej 250 (dyqind e pesdhjete) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Nëse të pandehurit nuk e paguajn gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do të ua zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.

IV. Obligohen të pandehurit, që secili veç e veç, t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, po ashtu edhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

V. Palë të dëmtuar nuk kishte.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr.1126/22 të datës 13.06.2022 kundër të pandehurve: D.E., për shkak të veprës penale: Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe E.E., për veprën penale: Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të pandehurve të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e

2022:120043

aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se të pandehurit vërtetë e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohen të pandehurit, ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtarja e vetme gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së, ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-YNC-043, i datës 20.05.2022; Raporti i oficerit i datës me numër të rastit 2022-YNC-043, i datës 20.05.2022; Raportet hetuese të policisë numër të rastit 2022-YNC-043; Procesverbalet mbi intervistimin e dy të pandehurve, të datës 20.05.2022 dhe 31.05.2022; Raporti mbi kërkimin e personave nga Sistemi për menaxhimin e kufirit dhe raporti mbi kërkimin e automjeteve nga Sistemi për menaxhimin e kufirit. Të gjitha këto janë prova të besueshme të cilat vërtetojnë se në veprimet e të pandehurëve ekzistojnë elemente të veprës penale: Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë edhe u shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për dy të pandehurit, konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar është dënim i drejtë dhe i ligjshëm dhe është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale, me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen të pandehurit të kenë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata

2022:120043

mundet të ashpërsojë dënimin kundër tyre, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 të Ligjit per Kompensimin e Viktimave të Krimit

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 364, 495 e 449 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Dega në Leposaviq
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.83/2022, datë 07.03.2024

GJYQTARJA
Mersiha Čalaković Pllana

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, të pandehurit apo mbrojtësi e tyre mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej tetë (8) ditësh, nga dita e pranimit të tij. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate.